VENDIM
Nr. 592, datë 18.10.2023

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN E JAGODINËS, BASHKIA ELBASAN, QARKU ELBASAN, NGA BASHKIMI I PËRKOHSHËM I SHOQËRIVE "G.A.C" SHPK DHE "*LA PORTA DELLA LUCE*" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën e Jagodinës, Bashkia Elbasan, qarku Elbasan, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive "G.A.C" sh.p.k. dhe "*La Porta Della Luce*" sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: bashkimi i përkohshëm i shoqërive "G.A.C" sh.p.k. dhe "*La Porta Della Luce*" sh.p.k.;

b) Numri i identifikimit personal, NIPT/NUIS: "G.A.C" sh.p.k.: L61619031A ; "*La Porta Della Luce*" sh.p.k.: M22707205L;

c) Tipi centralit: fotovoltaik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 10 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të parkut fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në zonën e Jagodinës, Bashkia Elbasan, qarku Elbasan;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionin e projektit;

g) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën e Jagodinës, Bashkia Elbasan, qarku Elbasan, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një subjekt i tretë, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

gj) Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "G.A.C" sh.p.k. dhe "*La Porta Della Luce*" sh.p.k., ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet bashkimit të përkohshëm të shoqërive "G.A.C" sh.p.k. dhe "*La Porta Della Luce*" sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat

dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimi i përkohshëm i shoqërive "G.A.C" sh.p.k. dhe "*La Porta Della Luce*" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKS 1

Koordinatat e centralit elektrik fotovoltaik Në zonën e Jagodinës, Bashkia Elbasan, qarku Elbasan Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "G.A.C" sh.p.k. dhe "*La Porta Della Luce*" sh.p.k.					
Nr.	E	N	Nr.	E	N
1	501494.6	4548681	8	501831.5	4548897
2	501752.2	4548954	9	501868.6	4548875
3	501777.4	4549019	10	501814.5	4548804
4	501950.8	4549161	11	501841.9	4548790
5	502131.9	4548958	12	501660.8	4548548
6	502109.7	4548926	13	501660.8	4548681
7	501910.6	4548987